



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Gusht, 2016

SBASHK-u u takua me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij

Përpjekje për adresimin e drejtë të çështjeve dhe kërkesave



Pas një takimi përgatitor me Kabinetin e Ministrit Bajrami, me kërkesën e SBASHK-ut është mbajtur një takim përmbajtjesor në Kabinetin e Ministrit Bajrami . Në këtë takim janë analizuar një për një kërkesat me shkrim që SBASHK-u i kishte dërguar në adresë të Ministrit... (faqe 4)

Edhe një dëshmi e frymës demokratike në SBASHK

Do të vepohet sipas deklarimeve me nënshkrime të anëtarësisë



SBASHK-u vazhdimisht është angazhuar dhe ka marrë veprime sipas kërkesave dhe mbështetjes... (faqe 4)

SBASHK-u përmbyll me sukses trajnimet për dialogun social

Përfaqësuesit e Universiteteve, të Muzeut dhe të Qendrës së Studentëve ishin të përkushtuar



Krahas angazhimeve të shumta për realizimin e kërkesave të anëtarësisë, SBASHK-u i ka dhënë rëndësi edhe realizimit ... (faqe 5)

Edhe një angazhim i SBASHK-ut në shërbim të arritjeve edhe më të mëdha në arsim

Përpjekje për të ndihmuar mësimdhënësit në vlerësimin e nxënësve

Krahas angazhimeve dhe arritjeve të shënuara të SBASHK-ut për realizimin ... (faqe 6)

Intervistë me nënkryetarin e SBASHK-ut, z. Rexhep Sadiku

Fryma e mirëbesimit dhe uniteti forcë e madhe e SBASHK-ut

Rexhepi është profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe. Në vitet e vështira të Kosovës ai i është kundërvënë ... (faqe 3)



Editorial



Kolegë e kolege ia nisem edhe një beteje për dituri të reja. Kudo në botë, pra edhe në vendin tonë, por ndodhin zhvillime të shpejta të shkencës dhe teknologjisë. Kjo kërkon nga të gjithë ne angazhime të reja që të përvetësojmë njohuritë dhe të mos mbesim prapa arritjeve e njohurive të reja. Kjo sfidë nuk është e lehtë sidomos për ata që janë në moshë pak më të shtyrë, por ne kemi forcë e besim në vetën tonë sepse kishim në të kaluarën plot sfida

edhe më të vështira, por i përballuam dhe nuk ndaluan se ecuri drejt arritjeve të reja.

SBASHK-u dhe unë si kryetar krenohemi me anëtarësinë tonë. Krenohemi me vullnetin, forcën, dashurinë për dijen dhe atdheun . Krenohemi me unitetin dhe përkushtimin tuaj. Ju pretojme se edhe gjatë këtij viti shkollor do të vazhdojmë të jemi zëri juaj kudo në institucione e me qëllim të realizimit të kërkesave . Po ashtu ju pretojme se do të vazhdojmë me vizita nëpër komuna për t'u takuar me ju dhe bashkërisht të angazhohemi për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim dhe për bashkëbisedë lidhur me të gjitha çështjet që na preokupojnë .

Kolegë e kolege urime fillimi i këtij viti shkollor . Na priftë e mbara.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me nënkryetarin e SBASHK-ut, z. Rexhep Sadiku

Fryma e mirëbesimit dhe uniteti forcë e madhe e SBASHK-ut



Rexhepi është profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe. Në vitet e vështira të Kosovës ai i është kundërvënë hapur politikës antishqiptare të sistemeve dhe të pushtuesit. Ishte i suspenduar nga puna për vite të tëra, kurse në vitin 1989 ishte në mesin e intelektualëve të Kosovës që

u izoluan dhe përjetuan dhunë e tortura të tmerrshme në burgjet serbe. Ai tani është nënkryetar i SBASHK-ut dhe shquhet me aftësinë e komunikimit të lehtë dhe të krijimit të atmosferës së mirë me bashkëbiseduesit.

Arsimimi Sot:

1. Kush është Rexhep Sadiku?

Sadiku: Unë rrjedh nga një familje e varfër. Jam i lindur në Reçak të Shtimes, më 12.04.1955. Kam të kryer Fakultetin Filozofik, dega e letërsisë e gjuhës shqipe në Prishtinë në vitin 1979. Kam punuar dhe vazhdoj të punoj si profesor. Në vitin 1983 deri më 1990 kam qenë i suspenduar si i papërshtatshëm ideo-politikisht. Më 1989 së bashku me shumë intelektualë kosovarë kam qenë i izoluar në burgjet e Serbisë.

Arsimimi Sot:

2. Aktiviteti juaj sindikal?

Sadiku: Objektivi im është rritja e vazhdueshme e anëtarësisë, sepse kjo forcon partneritetin e SBASHK-ut me MASHT. Mediet i shfrytëzoj racionalist në nivelin lokal, pasi që kërkojnë informacion nga unë. Po ashtu kam kontakte të frytshme me DKA në Ferizaj.

Arsimimi Sot:

3. Jeni nënkryetar i SBASHK-ut, sa është e lehtë kjo?

Sadiku: S'ka dilemë se pozita e nënkryetarit ka obligimet dhe përgjegjësitë e veta. Të jesh nënkryetar nuk do të thotë të jesh i privilegjuar, po njëkohësisht do të thotë të kesh integritet, tipare dhe gatishmëri përballë sfidave.

Nënkryetarët kanë kontakte të vazhdueshme me palët e dëmtuara. Ata marrin informacionet e të dëmtuarve dhe japin sugjerimet për palët. Gjuha e nënkryetarit duhet të jetë komunikative, e qartë, identifikuese, e thjeshtë dhe bindëse.

Arsimimi Sot:

4. Angazhimi sindikal në Kosovë?

Sadiku: SBASHK-u është organizatë e fuqishme, e cila merret me avancimin e vlerave materiale, profesionale e edukativo-arsimore. Synimi ynë është qëndrueshmëria e vlerave të mirëfillta arsimore si dhe krijimi i një klime e atmosfere të mirëfilltë për të arritur në majat më të larta për një mësim sa më efikas e bashkëkohor. Ne, si SBASHK po përpiqemi që jo vetëm të krijojmë bazën e infrastrukturës së nevojshme ligjore, por njëkohësisht marrëveshjet në mes SBASHK e MASHT të materializohen tërësisht. Kam bindjen se ne, së bashku me anëtarësinë do të arrijmë edhe më tej drejt realizimit të qëllimeve tona. Duhet theksuar se SBASHK ka reputacion qoftë në opinionin e brendshëm, qoftë në sindikatat botërore, sepse është dëshmuar me qasjen, vizionin dhe përkushtimin ndaj problemeve që u dalin anëtarëve tanë.

Arsimimi Sot:

5. Sa është përfshirja e të rinjve dhe femrave në arsim në komunën nga vini ju?

Sadiku: Është në tendencë e sipër që femrat dhe të rinjtë të integrohen në jetën organizative sindikale. Në Ferizaj ka dy femra në kryesi dhe pesë kryetare të shoqatave sindikale. Kjo dëshmon se ka hapësirë për inkurajim të femrave dhe të rinjve për t'u kyçur më aktivisht në strukturat sindikale.

Arsimimi Sot:

6. Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Sadiku: Frymën e mirëbesimit nëpër nivele komunale. Kjo dëshmon për aktivitetin e SBASHK-ut si dhe kontaktet e vazhdueshme që ka me ministrinë e Arsimit në të mirë të anëtarësisë.

Arsimimi Sot:

7. A keni ndonjë këshillë apo porosi për SBASHK-un ?

Sadiku: Ta ruajë frymën e unitetit e konstruktivitetin sa më shumë, sepse këtu qëndron fuqia jonë.

Arsimimi Sot:

8. Për fund?

Sadiku: Me mirëkuptim, sinqeritet dhe angazhim të përbashkët të hapërojmë për suksese në fushëbetjën tonë!

Gjatë muajit

SBASHK-u u takua me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij

Përpjekje për adresimin e drejtë të çështjeve dhe kërkesave



Pas një takimi përgatitor me Kabinetin e Ministrin Bajrami, me kërkesën e SBASHK-ut është mbajtur një takim përmbajtjesor në Kabinetin e Ministrin Bajrami . Në këtë takim janë analizuar një për një kërkesat me shkrim që SBASHK-u i kishte dërguar në adresë të Ministrin, Prof. Dr. Arsim Bajrami.

Ministri Bajrami ka deklaruar se vlerëson angazhimet e SBASHK-ut dhe se kupton kërkesat e tyre. Ai ka shtuar se një pjesë e kërkesave nga Kontrata Kolektive e që

kanë qenë obligim i MASHT dhe Qeverisë qendrore janë realizuar, por kanë mbetur obligime të qeverive lokale pa u vënë në jetë. Ministri ka shtuar se do të dërgojë një shkresë tek qeveritë lokale për të kërkuar angazhimin e tyre e po ashtu kërkesat e SBASHK-ut do t'i prezantojë edhe një herë në takimin me drejtoritë arsimore. Ai po ashtu është shprehur i gatshëm që me delegacionet e SBASHK-ut të takohet me Kryeministrin Mustafa dhe me përfaqësues të tjerë të Qeverisë për të arritur te zgjidhja e kërkesës lidhur me Ligjin për statutin e punëtorëve të arsimit të Republikës së Kosovës për vitet 89/99.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, i kanë deklaruar Ministrin Bajrami se SBASHK-u është i përkushtuar që zgjidhjet të bëhen përmes dialogut, por nëse kjo nuk ndodh atëherë do të shkohet edhe në veprime sindikale, për të cilat do të vendos Këshilli Drejtues, që përfaqëson zërin e të punësuarve në arsimin e Kosovës dhe në shkencë e kulturë.

Edhe një dëshmi e frymës demokratike në SBASHK

Do të veprohet sipas deklarimeve me nënshkrime të anëtarësisë

SBASHK-u vazhdimisht është angazhuar dhe ka marrë veprime sipas kërkesave dhe mbështetjes së fuqishme të anëtarësisë. Kështu u veprua edhe para fillimit të këtij viti shkollor kur në të gjitha shkollat u shpërndanë formularët duke i dhënë mundësi secilit anëtarë të SBASHK-ut që të deklarohej lidhur me çështjet me rëndësi.

Nr.	Emri dhe Mbanja	Datëllogja	Nr.personal	Deklarimi i bërë me testimin me shkollën	
				Për	Qëndër
1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20

Punëtorët e arsimit të komunës së Vitisë me nënshkrime kundërshtojnë organizimin e testimit të mësimdhënësve

vic: 23/08/2016 Im Bajrami Print Email
Në organizim të Sindikatës së Arsimit në Viti, edhe në shkollat e lësjaj komune, ka filluar nënshkrimi i peticionit nga mesimdhënësit, përmes së cilit ata kundërshtojnë vendimin e ministrisë së arsimit të marrë më parë, për organizimin e testimit të mesimdhënësve në

" Unë anëtar i SBASHK-ut, me nënshkrimin tim kërkoj nga kryetari i SBASHK-ut që konform Statutit të SBASHK-ut, Ligjit mbi organizimin sindikal , Ligjit mbi grevat dhe Konventave Ndërkombëtare të ndërmar të gjitha veprimet sindikale, duke mos përjashtuar as grevën e përgjithshme për realizimin në tërësi të Kontratës Kolektive, për aprovimin e Ligjit për statutin e mesimdhënësve për vitet 89-99 si dhe nëse bëhen shkelje



Kuvendi Sindikal i Arsimit fillor dhe Arsimit të mesëm në Komunen e Mitrovicës deklarohet kundër testimit me shkrim të mesimdhënësve. Behet shpërndarja e formulareve për deklaram individual të mesimdhënësve në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunes së Mitrovicës dhe në shkollat fillore me mesim në gjuhën shqipe të Komunes së Albanikut.



Like Comment Share

eventuale ndaj të drejtave të punëtorëve. Gjithashtu me nënshkrimin tim deklarohej edhe lidhur me testin me shkrim të paralajmëruar nga Ministri Bajrami”, thuhet

në fillimin e listave e pastaj është vendi për të dhënë shënimet e duhura dhe për të vënë nënshkrimin si dëshmi të mbështetjes . Po ashtu formulari ka edhe rubrikat për t'u deklaruar lidhur me paralajmërimin e ministrit Bajrami për testin me shkrim për mesimdhënësit duke dhënë mundësinë që mesimdhënësit lirshëm të deklarohen (për apo kundër). Formularët do të bashkohen në SBASHK dhe pastaj Këshilli Drejtues do të analizojë ata dhe në bazë të deklarameve të anëtarësisë edhe do të sjellë vendime lidhur me angazhimet në vazhdim. SBASHK-u po ashtu është duke vazhduar me angazhimet për t'u takuar me institucionet dhe për të gjetur zgjidhje me dialog.

SBASHK-u përmbyll me sukses trajnimet për dialogun social

Përfaqësuesit e Universiteteve, të Muzeut dhe të Qendrës së Studentëve ishin të përkushtuar



Krahas angazhimeve të shumta për realizimin e kërkesave të anëtarësisë, SBASHK-u i ka dhënë rëndësi edhe realizimit të Planit Strategjik duke organizuar një varg trajnimesh me anëtarësinë lidhur me dialogun social. Këto trajnime kanë pasur për qëllim që të fuqizojnë kapacitetet e SBASHK-ut të marrë pjesë aktive në proceset e dialogut social. Në këtë aktivitet janë përfshirë përfaqësues sindikalë nga të gjitha komunat e Kosovës dhe në mbyllje është organizuar e njëjta veprimtari me përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universiteti i Mitrovicës

"Isa Boletini", Universiteti i Shkencave Aplikative-Ferizaj, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Muzeu i Kosovës dhe Qendra e Studentëve. Në gjithë këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj , i cili vazhdimisht ka kujtuar arritjet e SBASHK-ut, por edhe sfidat që e presin sindikatën tonë.



Do theksuar se edhe në trajnimin e fundit për dialogun social trajnerët e licencuar Safet Beqiri e Ymer Ymeri, të ndihmuar nga kryetari Jasharaj kanë shtjelluar çështje me dialogun social duke u ndalur tek

përkufizimi, funksioni dhe sfidat e dialogut social, te momentet e veçanta që duhet pasur kujdes gjatë përgatitjeve për dialogun social dhe për çështje të tjera.



Meritojnë të lavdërohen edhe kësaj radhe trajnerët Beqiri e Ymeri për krijimin e një atmosfere pune e angazhimi dhe pjesëmarrësit prandaj nuk kanë qenë vëzhgues pasivë, por trajnimin e kanë kthyer në atmosferë të këndshme dhe përmes bashkëbisedës kanë dhënë kontributin e tyre në shtjellimin e qartë të

temave. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë punën e SBASHK-ut dhe kanë thënë se ky aktivitet do t'u ndihmojë atyre që të dinë të përgatiten për dialogun me partnerët social në Universitet, institucione tjera dhe me përfaqësues të Qeverisë qendrore.

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi kanë kërkuar që SBASHK-u edhe në të ardhmen të organizojë trajnime me qëllim të forcimit të kapaciteteve dhe të ngritjes së njohurive sindikale të anëtarësisë.



Edhe një angazhim i SBASHK-ut në shërbim të arritjeve edhe më të mëdha në arsim **Përpjekje për të ndihmuar mësimdhënësit në vlerësimin e nxënësve**



Krahas angazhimeve dhe arritjeve të shënuara të SBASHK-

ut për realizimin e kërkesave të anëtarësisë, janë duke u vazhduar angazhimet e dëshmuara e të suksesshme edhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë. SBASHK-u i mbështetur nga GIZ deri tani kanë organizuar aktivitetin “Roli i mësimdhënësve në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim” dhe “Roli i mësimdhënësve në përgatitjen e Planit Zhvillimor të Shkollës”. Pasi janë vlerësuar si të qëlluara këto dy aktivitete do të vazhdohet edhe me një angazhim të ri që ka për qëllim bashkëbisedën me mësimdhënës lidhur me vlerësimin sistematik të nxënësve. Edhe kësaj radhe SBASHK-u i mbështetur nga GIZ ka përgatitur fletëpalosje dhe posterë që lidhen me temën kyçe. “Rëndësia e vlerësimit të nxënësve në ngritjen e cilësisë në arsim” është aktiviteti i radhës, i cili do të mundësojë që të hapen diskutime dhe të shpalosen ide se si të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i njohurive të nxënësve përmes testeve dhe se çfarë duhet të kemi


kujdes me rastin e hartimit të këtyre testeve. Fletëpalosjet dhe posterët do të ofrojnë informata dhe këshilla lidhur me atë se çfarë do pasur kujdes para se



të nisim me hartimin e një testi dedikuar nxënësve. Në shenjë të respektit për misionin njerëzor që ka mësuesi në këto fletëpalosje kujtohet thënia anonime se : “*Një mësues i mirë është si qiri: ai konsumon vetveten për t'ua ndriçuar rrugën e të tjerëve.*”



SBASHK-u i bashkëngjitet aktiviteteteve të EI-së për 5 Tetorin - Ditën Botërore të Mësuesit Me një Konferencë tematike do të kujtohet kjo datë më rëndësi



SBASHK-u bashkë me të 32 milionë kolegët nga e tërë bota do të organizojnë aktivitete në bazë të një programi të Internacionales Botërore të Arsimit e me qëllim të krenimit të 5 tetorit – Ditës Botërore të Mësuesit.

Tema e Konferencës do të jetë “*Duke vlerësuar mësuesit, përmirësojmë statutin e tyre*”. Veprimtaritë e zhvilluara në këtë vit shënojnë festimin e 50 vjetorit të miratimit të Rekomandimit të ILO/UNESCO mbi statutin e mësuesit. Do kujtuar se Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, UNESCO, në vitin 1994, ka përcaktuar 5 Tetorin si Ditën Botërore të Mësuesit, për të përkujtuar nënshkrimin e Rekomandimit, në lidhje me Statusin e Mësuesve, miratuar nga ana e ILO/UNESCO, në Paris, më 5 Tetor 1966. Po në këtë vit, sipas idesë dhe sugjerimit të UNESCO-së, pedagogu zviceran Robert Dottrens (1893 - 1984)

hartoi edhe betimin solemn të mësuesit mbi bazën e betimit të Hipokratit. Pëmbajtja e këtij betimi është:

“Do ta kryej detyrimin tim me ndërgjegje dhe krenari. Nxënësit e mi nuk do të jenë vetëm nxënës, por edhe fëmijë dhe kurrë nuk do t’i harroj që për fatin e tyre edhe vetë të mbaj një pjesë të përgjegjësisë.

Do ta mbroj me të gjitha mjetet ekzistuese nderin e profesionit të arsimitarit.

Kolegët e mi çdo herë do të jenë edhe miqtë e mi. Në bashkëpunim me ta do të përpiqem që, vazhdimisht, ta përkryej veprimtarinë e shkollës në kuptimin efikas të njohjes së të gjithave të drejtave në edukimin dhe barazinë sociale në arsim. Këtë betim solemn e jap plotësisht në mënyrë të lirë dhe me nderë“

Në Konferencën që do të organizohet nga SBASHK-u do të jenë të ftuar përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, veteranë dhe njohës të arsimit dhe punëtorë të arsimit nga e tërë Kosova.